Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0793

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje individuale nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE "V-SH Loti" SHPK, ushtruar kundër Vendimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Zhvarrosja, transporti, arkivoli, varrosja, vendosja e gurëve me mbishkrime" evidentuar me numër të prokurimit "KEK-23-3646-2-2-1" iniciuar nga Korporata Energjetike e Kosovës SHA, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) me 16.11.2023, mori:

Vendim

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e OE "V-SH" Loti SHPK ushtruar me 13.10.2023, Protokolli 2023/0793 dhe mbetet në fuqi Vendimi i AK i datës 29.09.2023 për dhënien e kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Zhvarrosja, transporti, arkivoli, varrosja, vendosja e gurëve me mbishkrime" evidentuar me numër të prokurimit "KEK-23-3646-2-2-1".

2. Konfiskohet shuma e mjeteve të depozituara në emrin e tarifës ankimore dhe të njëjtat kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës, sikurse parashihet me 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP, lidhur me nenin 118 të LPP.

Arsyetim

Me 13.10.2023,OE "V-SH" Loti SHPK ka ushtruar ankesë në OSHP, me të cilin ka atakuar Vendimin e AK të datës 29.09.2023 për dhënien e kontratës për OE të rekomanduar, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Zhvarrosja, transporti, arkivoli, varrosja, vendosja e gurëve me mbishkrime" evidentuar me numër të prokurimit "KEK-23-3646-2-2-1".

Paraprakisht konstatohet se lidhur me ketë aktivitet të prokurimit, AK ka zhvilluar procedurë të hapur, sikurse përkufizohet me dispozitën e nenit 4, paragrafi 1.37, të LPP, lloji i kontratës shërbim, sikurse përkufizohet po ashtu me dispozitën e nenit 4, paragrafi 1.56, lidhur me nenin 8 dhe Vlera e parashikuar 63, 000.00 €, e cila i referohet autorizimeve të autoritetit kontraktues, mes tjerash lidhur me nenin 17 të LPP.

Nga shikimi i gjithmbarshëm i shkresave të kësaj lënde, konstatohet se çështja në rastin konkret edhe me parë ka qenë lëndë e procesit ankimor dhe se OSHP ka vendosur sipas Vendimit PSH

Nr. 2023/0316; Nr. 2023/513 dhe PSH Nr. 2023/501.

Me rastin e shqyrtimit paraprak

Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtroj ankesë në OSHP pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bie nën kompetencat e këtij organi kuptim të nenit 105 të LPP.

OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues sipas nenit 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 02.11.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- Ankesa te refuzohet si e pabazuar;
- Te mbetet ne fuqi vendimi i AK-se

Konstatohet se raporti i ekspertizës përmban të gjitha elementet qenësore përkitazi me pretendimet ankimore dhe i njëjti është pranuar nga palët, me ç 'rast AK është pajtuar me mendimin e ekspertit ndërsa ankuesi nuk është pajtuar.Në vijim konstatohet se palët janë të informuara lidhur me të gjitha shkresat kësaj lënde sikurse kërkohet me paragrafin 2, të nenit 20 të kësaj Rregullores për punën e Bordit të OSHP-së. Paneli konstatoi më tej se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, sikurse kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores së cituar, prandaj analizoi në vijim të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të caktohet seanca publike me palë dhe se lidhur me çështjen në rastin konkret mund të vendoset në mënyrë meritore, sikurse parashihet me dispozitën e nenit 24, paragrafi 1, të Rregullores së Punës së OSHP.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave-

Në procesin e administrimit me provat dhe shkresat e kësaj lënde, Paneli mori në konsideratë të gjitha faktet dhe provat të cilat konsiderohen të tilla nga pohimet e ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe analizat dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, të cilat janë prezantuar shkurtimisht në vijim të këtij arsyetimi.Në ketë rast duhet theksuar se sipas Letrës standarde për tenderuesin e pasuksesshëm të datës 29.09.2023 (drejtuar ankuesit) autoriteti kontraktues ka theksuar se, cituar: "...tenderi i juaj nuk qe tenderi me çmimin më të ulët në mesin e tenderëve të cilët i plotësuan kërkesat e dhëna në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit". Në të vërtetë, e ashtuquajtura *Letra standarde* e cituar si më sipër, ju drejtohet njëherësh dhe atyre operatorëve ekonomik të cilët i kanë plotësuar në parim të gjitha kushtet e parapara dhe të specifikuara me dosjen e tenderit (DT) dhe me njoftimin për kontratë (NJK), mirëpo në procesin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, sikurse kërkohet me dispozitën e nenit 59 të LPP, natyrisht se autoriteti kontraktues duhet të vendos për njërin prej tyre. Megjithatë në kontekstin e kushteve të plotësuara, të ekzaminuara dhe të krahasuara në kuptim të dispozitës së cituar, të njëjtat po ashtu duhen vlerësuar në harmoni dhe me paragrafin 1, nën-paragrafi 1.1, të nenit 60 të LPP (kriteret për dhënien e kontratës) sipas të cilit "autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët".

OE "V-SH" Loti SHPK, nga cilësia e tij si ankues ka atakuar vendimin e datës 29.09.2023 me pohimin se AK nuk i ka respektuar dispozitat e LPP, kryesisht nenin 59 të LPP meqë ka rekomanduar për kontratë një OE i cili nuk i plotëson kriteret e dosjes së tenderit. Më tej, Ankuesi pretendon se siç thuhet, cituar: "...bazuar në kërkesat e kualifikimit dhe të gjendjen faktike të ofertës së OE të rekomanduar" AK ka shkelur dispozitën e nenit 69, paragrafi 4, sipas të cilit potencohet se për procedura të prokurimit që kanë të bëjnë me sigurim të shërbimeve, AK mund të kërkoj nga OE që të sigurojnë të dhëna me të cilat dëshmohet aftësia e tyre profesionale për ofrimin e këtyre shërbimeve. Lidhur me ketë, Paneli vëren se në raportin e ekspertit shqyrtues janë marrë në konsideratë të gjitha pretendimet ankimore të cilat janë analizuar nga aspekti i kritereve të publikuar në DT, përfshirë dhe korrespodencën me AK (pa nevojë që sërish të përshkruhen të gjitha ato) dhe ka konstatuar se pohimet e cituara si më sipër të ankuesit, nuk qëndrojnë sepse AK paraprakisht ka analizuar dhe verifikuar mes tjerash edhe *aftësia e tyre profesionale* për ofrimin e këtyre shërbimeve. Paneli shqyrtues sqaron se sa i përket kritereve të cilat mund të mos jenë të kuptueshme apo jo ligjore atëherë OE këtë duhet ta paraqesin në fazën para dorëzimit të ofertës duke kërkuar sqarime shtesë, dhe po ashtu ka të drejtë ti drejtohet edhe organit shqyrtues të prokurimit duke i atakuar këto kërkesa, gjë e cila në rastin konkret nuk ka ndodhur nga OE ankues dhe me paraqitjen e ofertës OE konsiderohet se është pajtuar me kërkesat e Dosjes së Tenderit. Andaj, PSH në rastin konkret i referohet vetëm dispozitave ligjore mbi të cilat AK mund të paraqes kërkesën. Kështu që, vlerësimi i ofertave duhet të bëhet konform nenit 59 të LPP. Rrjedhimisht sipas nenit 56.3 të LPP "*Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit*".

Me tej (në kontekstin e pretendimeve ankimore të evidentuara nën rendor 2) ankuesi ka pohuar OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk posedon kod veprimtarie dhe nuk ka eksperiencë lidhur me natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit. Duke ju referuar pohimit si më sipër, eksperti shqyrtues ka konstatuar se kodi i një veprimtarie të tillë nuk ishte parashikuar shprehimisht sipas kritereve të DT duke shpjeguar në ketë rast se (*në të kundërtën*) cituar: "pretendimi për eliminim eventual do të ishte në kundërshtim me paragrafin 3 të nenit 56 të LPP". Prandaj, lidhur me ketë Paneli mbështet konstatimin e ekspertit shqyrtues përderisa sipas dispozitës së cituar vërtetë parashihet se "Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".Ankuesi ka atakuar vendimin e cituar si më sipër të AK po ashtu dhe sipas pohimit se AK nuk ka dhënë arsye, siç thuhet cituar: "për eliminimin e OE pjesëmarrës në ketë aktivitet të prokurimit, përfshirë dhe ofertën tonë". Mirëpo nga sa vërehet nga shkresat e kësaj lënde dhe nga shqyrtimi paraprak i ekspertit shqyrtues vërehet se AK i ka komunikuar në fakt arsyet e eliminimit të cilat janë komunikuar fare qartë sipas Letrës standarde për tenderuesin e pasuksesshëm të datës 29.09.2023 dhe konsiderohen të mjaftueshme (natyrisht nga pikëpamja e këtij Paneli) në raport me synimin dhe rrjedhën e procesit të prokurimit.

- *Përfundim –*

Bazuar shkurtimisht në faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, të analizuara nga konteksti i pavarësisë profesionale dhe kompetencave të parapara shprehimisht me dispozitën e nenit 105 të LPP, Paneli vëren se eksperti shqyrtues i ka shqyrtuar me kujdes pohimet ankimore duke i analizuar në raport me kërkesat, kriteret dhe specifikat e parashikuara në dosjen e tenderit (DT)

dhe në njoftim për kontratë (NJK) dhe me ketë rast vendosi që ta mbështes raportin e ekspertit shqyrtues. Paneli Shqyrtues konsideron se hartimi i DT është parashikuar me dispozitën e nenit 27 të LPP dhe përbën dokumentin kryesor për të gjitha palët e përfshira në një aktivitet të prokurimit. Kurse për çdo paqartësi lidhur me kushtet dhe specifikimet e përcaktuara nga një AK në DT, secili OE ka të drejtë që sipas nenit 53 të LPP të kërkoj sqarime shtesë nga AK, natyrisht brenda afatit ligjor po ashtu të specifikuar në DT. Nga ana tjetër, në paragrafin 4 të nenit 59 të LPP thuhet se, cituar: "autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit..." Prandaj Paneli konsideron se duke u bazuar në raportin e ekspertit dhe në kërkesat e Dosjes së Tenderit AK ka vepruar në harmoni me nenin 59 dhe 60 të LPP.

Prandaj pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve ankimore, analizës se tyre dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, Paneli vlerësoi se ankesa nuk është e bazuar dhe seVendimi i atakuar i AK i datës 29.09.2023 për dhënien e kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër, mbetet në fuqi. Paneli vuri si gjithnjë në zbatim edhe nenin 103 të LPP-së sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një subjekti në procedurë. Përgjegjësinë e mbarëvajtjes të tërësi të aktivitetit të prokurimit duhet ta ketë AK, sipas nenit 24.2 të LPP, i cili citon: "*Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj*". Ashtu siç e ka përgjegjësi edhe për kërkesat e nenit 65 të LPP.

Prandaj bazuar në të lartcekurat dhe duke vepruar në pajtim me kompetencat e parapara me nenin 98, 99, 104 dhe 105 të LPP Paneli Shqyrtues vendosi sikurse në dispozitiv të këtij vendimi, kurse lidhur me tarifën ankimore, Paneli Shqyrtues vendosi konform nenit 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP, lidhur me nenin 118 të LPP.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**
- OE - **V- SH " Loti " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: